



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM
Nr. 458, datë 07.10.2021

PËR
PËRFUNDIMIN E KOHËZGJATJES SË KOMANDIMIT TË GJYQTARES
ZNJ. FLOJERA DAVIDHI NË POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË NJËSINË
MBËSHTETËSE TË KOMISIONEVE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 207, datë 11.10.2019 “Për komandimin e gjyqtares Flojera Davidhi në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, pasi shqyrtoi Njoftimin e znj. Flojera Davidhi, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4516, datë 04.10.2021, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. Flojera Davidhi në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor në fund të afatit të komandimit, më datë 21.10.2021.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. Flojera Davidhi sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR